L I G J
Nr.9574, datë 3.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 "PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve" zëvendësohet me emërtimin "Struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve.".

Neni 2

Pika 4 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:
"4. Shoqëria e tregtimit me shumicë përgjigjet për sasinë dhe cilësinë e ngarkesës gjatë transportit.".

Neni 3

Neni 12.1 shfuqizohet.

Neni 4

Kudo në nenin 17 hiqen fjalët "Leje përpunimi".

Neni 5

Neni 18.1 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21

Personat juridikë, që paraqesin kërkesë për leje tregtimi, sipas nenit 19 të këtij ligji, janë të detyruar të plotësojnë kushtin e kapacitetit të depozitimit në instalimet, prona të tyre ose të marra në përdorim me kontratë, për një periudhë kohore të barabartë me atë të vlefshmërisë së lejes së tregtimit. Kushtet e dhënies së lejes së tregtimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Kushti i kapacitetit të depozitimit specifikohet, sipas llojit të lejes dhe kategorisë së produkteve që tregtojnë.".

Neni 7

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët "Impiante përpunimi" dhe "Leje përpunimi" hiqen.

b) Paragrafi i fundit i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"Masa e gjobës, e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, jepet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e hidrokarbureve, ndërsa të gjitha gjobat e tjera jepen nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4990, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu